

KUFIJ MË TË LARTË PËR PENSIONIN E PARAKOHSHËM

Ndryshe nga sa premtoi gjatë fushatës zgjedhore, qeveria Meloni jo vetëm që nuk ka bërë as amendamentin më të vogël në ligjin Fornero, por ka rritur gjithashtu kriteret që duhet të përmbushin punonjësit për të dalë në pension herët.

...POR JU JENI PUNËTOR NDËRTIMI...

NË KUADËR TË MARRËVESHJES KOMBËTARE KOLEKTIVE TË PUNËS, JU E KENI NJË MUNDËSI...

KUFI MË I LARTË PËR KUALIFIKIMIN PËR PËRFITIMIN E "APE SOCIALE"

Pragu i moshës për të përfituar "Ape Sociale" është rritur me 5 muaj. Tani duhet të jesh 63 vjeç e 5 muaj për t'u kualifikuar për këtë përfitim, në vend të moshës 63 vjeç, siç ka qenë më parë.

Ki parasysh se për të përfituar nga "Ape Sociale" për punë të vështirë, duhet të verifikohet kodi i saktë i ISTAT-it. Kontaktoni pikën më të afërt të Fillea ose zyrën e Patronato Inca.

PËRFITIMI I PENSIONIT TË PARAKOHSHËM "QUOTA 103" I PAZBATUESHËM

Pavarësisht zgjatjes deri në fund të vitit 2024, "Quota 103" (mosha 62 vjeç dhe 41 vjet kontribute) është bërë e pazbatueshme për shkak të shtimit të kushteve më të këqija. Për personat që kualifikohen në vitin 2024, pensionet do të jepen vetëm në bazë të rregullave të përllogaritjes së sistemit të kontributeve, duke bërë që punonjësit të humbin gjithë kuotën që u paguhet në kuadër të rregullave të përllogaritjes së sistemit të pagave, që është sistemi i përdorur deri më sot. Për më tepër, për punonjësit e sektorit privat që kualifikohen në vitin 2024, periudha e pritjes që përmbush kushtet kualifikuese dhe marrja e pensionit të parë do të rritet në shtatë muaj (deri tani ka qenë tre muaj).

SKEMA E DALJES SË PARAKOHSHME NË PENSION PËR GRATË "OPZIONE DONNA": PRAGU I MOSHËS ËSHTË RRRITUR ME 1 VIT

Pavarësisht asaj që është thënë vazhdimisht, qeveria e ka rritur pragun e moshës nga 60 në 61 vjeç. Kur arrihet ky prag moshe, vetëm tre kategori punonjësesh gra do të kualifikohen për skemën "Opzione Donna": gratë që kujdesen për anëtarët e familjes së tyre; gratë me aftësi të kufizuara të llogaritura në 74% ose më shumë; gratë që janë hequr nga puna ose që janë punonjëse në kompani që janë bërë objekt diskutimesh për kriza.

RILLOGARITJA E JETËGJATËSISË ËSHTË SHTUAR PËR DALJEN E PARAKOHSHME NË PENSION DHE "LAVORATORI PRECOCI" (PUNONJËSIT ME 12 MUAJ KONTRIBUTE PENSIONI TË DERDHURA PARA MOSHËS 19-VJEÇARE)

Opsioni i pensionit të parakohshëm për burrat me 42 vjet e 10 muaj kontribute dhe gratë me 41 vjet e 10 muaj kontribute pavarësisht moshës, është përjashtuar nga rillogaritja e jetëgjatësisë deri më 31.12.2026. Qeveria Meloni ka bërë aktualisht rillogaritjen e jetëgjatësisë me efekt nga data 1 janar 2025. Për këtë arsye, ekziston rreziku që të gjitha kriteret të rriten vitin tjetër.

PRAGJET JANË RRRITUR PËR HYRJEN NË SKEMËN E KONTRIBUTEVE TË PENSIONIT TË PARAKOHSHËM

Punonjësit që kanë filluar të punojnë pas datës 1 janar 1996 kualifikohen për pension të parakohshëm në moshën 64-vjeçare dhe me një prag minimal kompensimi të pensionit. Deri më sot, pragu ka qenë 2,8 herë sa asistensa sociale (rreth 1496 euro); ndërsa tani është rritur në 3 herë sa asistensa sociale (rreth 1603 euro). Nëse nuk e arrini këtë prag, nuk kualifikoheni për një pension.



CGIL**afatet****FILLEA**

Përfitimet "APE SOCIALE"
deri më 31 mars 2024
ose deri më 15 korrik 2024
dhe jo më vonë se data 30
nëntor 2024

"LAVORATORI PRECOCI"
(punonjësit me 12 muaj kontribute pensioni të
derdhura para moshës 19-vjeçare)
afati i parë: 1 mars 2024
afati i dytë: 30 nëntor 2024

Nëse jeni punëtor ndërtimi, në kuadër të Marrëveshjes Kombëtare Kolektive të Punës, mund të dilni në pension të paktën 4 vjet përpara dhe të shtoni pensionin suplementar...

FONDO ANTICIPO PENSIONISTICO [FONDI PARAPRAK I PENSIONIT] I RI

Fondo Anticipo Pensionistico, i paguar nga Casse Edili, ka dyfishuar periudhat e mbulimit të punëtorëve pas pagesës së përfitimeve të papunësisë në kuadër të skemës NASpl ose Nuova Assicurazione Sociale për punën që kanë përfunduar.

Punëtorët mund të zgjedhin një nga tre opsionet e mëposhtme, të paguara plotësisht nga Sistema Bilaterale [Sistemi bilateral]:

- **deri në 24 muaj** kontribute + 24 muaj kompensimi të pagës të paguar në të njëjtën kohë (pasi përfundon periudha e NASpl);
- **deri në 48 muaj** kontribute vullnetare (për këdo që nuk ka paguar ende 20 vjet kontribute dhe gjithmonë pas periudhës së NASpl);
- **vetëm deri në 36 muaj** vetëm shtesë të pagës (pas periudhës së NASpl).

Kompensimi i pagës është i barasvlershëm me kompensimin e NASpl në muajin e parë të pagesës*.

Ka gjithashtu një dispozitë që NASpl duhet të jepet si shtesë, sërish nga Casse Edili, nga momenti kur fillon reduktimi gradual, derisa të ndërpriten pagesat.

Kjo do të thotë që gjatë gjithë periudhës së NASpl, punëtorët do të vazhdojnë të marrin të njëjtën shumë që marrin nga INPS gjatë muajit të parë të papunësisë.

Shtesa duhet të paguhet nga Casse Edili çdo dy muaj.

* (për vitin 2023 deri në një maksimum prej 1470,99 eurosh në muaj për punëtorët që kanë të drejtën e shumës së plotë, siç përcaktohet me ligj)

PENSIONE SHITESË: MË SHUMË KONTRIBUTE TË JASHTME

Pagesa e re do të bëhet nga data 1 janar 2024.

Sistema Bilaterale do të paguajë tek Fondi di Previdenza Integrativa [Fondet e pensioneve shtesë] (Prevedi dhe Previdenza Cooperativa) një shtesë prej 1% në muaj për gjithë punëtorët që kanë zgjedhur vullnetarisht të regjistrohen për fonde pensioni, duke bërë kontributin e tyre prej 1%.

Për këtë arsye, krahas kontributit kontraktual që varion nga 10 deri 20 euro në muaj (në varësi të gradës së punëtorëve dhe orëve të punës), punëtorët e ndërtimit që kontribuojnë me 1%, do të marrin 2% të tjera: 1% nga punonjësi dhe 1% nga Sistema Bilaterale

SHEMBULL I BAZUAR NË NJË PAGË BRUTO PREJ 1800 EUROSH/MUAJ:

**1% kontribut vullnetar për punëtor:
18 euro**

+

**+ 1% kontribut shtesë nga punëdhënësi:
18 euro**

+

1% nga Sistema Bilaterale: 18 euro

=

TOTALI 54 EURO

**Punëtori paguan 18 euro dhe Fondi
merr 54 euro/muaj
(krahas kontributit kontraktual).**

Për informacione të mëtejshme, kontaktoni pikën më të afërt të Fillea Cgil ose zyrën e Patronato Inca Cgil

WWW.FILLEACGIL.NET



PATRONATO WWW.INCA.IT